



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 80 Prot

Tiranë, më 11, 06, 2013

VENDIM QARKULLUES Nr. 259, datë 11, 06, 2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve Vrana, Pepaj, Gjonpepaj, Nikaj, Livadhet e Mëdha, Marash, Curraj 1&2, Curraj 3, Curraj 4, Qereç Mulaj dhe Lekbibaj (Komuna Lekbibaj, Tropojë) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "TELEMENIA CURRAJ" sh.p.k., Shkodër,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "Vrana, Pepaj, Gjonpepaj, Nikaj, Livadhet e Mëdha, Marash, Curraj 1&2, Curraj 3, Curraj 4, Qereç Mulaj dhe Lekbibaj (Komuna Lekbibaj, Tropojë), paraqitur nga Subjekti "TELEMENIA CURRAJ" sh.p.k., Shkodër.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër bazuar në kontratën dypalëshe midis "TELEMENIA CURRAJ" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("TELEMENIA CURRAJ" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK